

Udhëheqja me shërbimet e sigurisë - zbulimit në

MAQEDONI



Udhëheqja me shërbimet e sigurisë - zbulimit në Maqedoni

Ky tekst është i punuar si pjesë e projektit "Përforcimi i mbikëqyrjes mbi shërbimet e sigurisë- zbulimit në Ballkanin Perendimor" të Qendrës së Gjenevës për kontrollin demokratik mbi forcat e armatosura. Projekti është i mundësuar me përkrahjen e përzemërt të Ministrisë së punëve të jashtme holandeze. Versioni anglez i tekstit do të shpallet si kapitull i veçantë në publikimin që vijon: Hans Born, Miroslav Haxhiq dhe Aidan Vils (redaktorë). Drejtimi me zbulimin në Ballkanin Perendimor (në përgatitje).

Andreja Bogdanovski¹

Shkup, prill 2012

¹ Autori është hulumtues në fushën e sigurisë në tink-tenk organizatën "Analitika" (www.analyticamk.org). Me të mund të kontaktoni në abogdanovski@analyticamk.org ose bogdanovski.a@gmail.com.

Përmbajtja:

1. Hyrje
 2. Organizimi i agjensioneve të zbulimit
 - 2.1 Gjendja
 - 2.2 Agjensioni për zbulim (AZ)
 - 2.3 Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim (DSK)
 - 2.4 Sektori-Shërbimi për siguri ushtarake dhe për zbulim (SShSUdheZ)
 - 2.5 Bashkëpunimi në mes të agjensioneve për zbulim
 3. Ndryshimet e propozuara në sektorin për siguri dhe zbulim
 4. Organet mbikëqyrëse
 - 4.1 Avokati i popullit
 - 4.2 Kuvendi
- Raportimi
- Procesi i kontrollit
- 4.3 Komisioni për finansim dhe buxhet i Kuvendit
 - 4.4 Mbledhjet plenare të Kuvendit
 - 4.5 Gjyqësori
 - 4.6 Këshilli i sigurisë nacionale
 - 4.7 Enti shtetëror për revizion
5. Mediumet dhe shoqëria civile
 6. Përfundimi
 7. Rekomandimet
- Bibliografia

Lista e shkurtesave

SShSUdheZ	Sektori-Shërbimi për siguri ushtarake dhe zbulim
DSK	Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim
BDI	Bashkimi Demokratik për Integrim
AZ	Agjensioni për zbulim
MM	Ministria e mbrojtjes
MPB	Ministria e punëve të brendshme
NATO	Organizata e traktatit të atlantikut verior
PAP-T	Plani aksional i partneritetit kundër terrorizmit
LSDM	Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
OBRM-PDUKM (VMRO-DPMNE)	Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas

1. Hyrje

Shërbimet maqedonase të sigurisë dhe zbulimit² nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha organizative që nga vitet e hershme të 1990-ës e këndeje, edhe pse disa modifikime janë bërë gjatë shpalljes së pavarësisë së shtetit në vitin 1991 dhe gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2001.³ Ky stagnim është në kundërshtim me kërcënimet dhe sfidat për sigurinë kombëtare maqedonase, të cilat dukshëm janë rritur gjatë njëzet viteve të kaluara. Dokumentet e fundit për mbrojtje dhe siguri, si rreziqe më të reja i identifikojnë kiberluftimin, rrezikun për mjedisin jetësor, armën për zhdukje masive dhe radikalizimin religjioz.⁴

Si përgjigje për këtë, Maqedonia, kohëve të fundit, përpiqet të gjejë kundërmasa me të cilat do të sillet në baraspeshë efektiviteti për ruajtjen e sigurisë kombëtare, rritja e përgjegjësisë së Qeverisë dhe respektimi i normave demokratike. Ndoshta, sfida më e madhe është pyetja se si të gjendet zgjidhje për kërcënimet në rritje të llojeve të ndryshme për sigurinë dhe njëkohësisht të sigurohet mbikëqyrje adekuate ndaj shërbimeve të sigurisë-zbulimit. Meqë Maqedonia ende është duke fuqizuar demokracinë e vet, shpesh kërkon modele për praktikë më të mirë në vendet tjera, të cilat në vete përfshijnë efektivitetin nga njëra anë dhe mbikëqyrjen e shoqërisë civile mbi shërbimet e sigurisë-zbulimit nga ana tjetër. Sidoqoftë, nga pavarësia në vitin 1991 e deri më sot, vendi lufton të vendos baraspeshë adekuate në këtë sferë.

Disa pyetje të lidhura me zbulimin, veçanarisht me përdorimin e masave speciale hetimore⁵ dhe shkëmbimin e informacioneve në mes të shërbimeve të sigurisë-zbulimit, i ndërlikuan raportet në mes të tri degëve të pushtetit – ekzekutiv, ligjdhënës dhe gjyqësor – si dhe në kuadër të vetë pushtetit ekzekutiv.

² Shërbimet e sigurisë-zbulimit të përfshira në këtë studim janë: Agjensioni për zbulim, Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim në kuadër të Ministrisë së punëve të brendshme dhe Sektori-Shërbimi për siguri ushtarake dhe zbulim në kuadër të Ministrisë së mbrojtjes.

³ Ky studim për ngjarjet e vitit 2001 e merr termin “konflikt i armatosur”, sipas përkufizimit të dhënë nga ana e Institutit për paqë dhe hulumtim të konflikteve në Universitetin Upsala: “Konflikti i armatosur është përplasje e qëllimeve të ndërsjella jokompatible dhe i intereseve që e prekin pushtetin dhe/ose territorin ku përdorimi i forcave të armatosura në mes të dy palëve, nga të cilat së paku njëra është qeveria e ndonjë shteti, rezulton së paku me 25 viktima.” (në dispozicion në: http://www.pcr.uu.se/research/ucdp/definitions/definition_of_armed_conflict/?languageId=1)

⁴ Islam Jusufi. “Politikat e sigurisë në Ballkanin Perëndimor”. Qendra për marrëdhënie civile-ushtarake – Beograd. (viti 2010): fq. 122-123.

⁵ Këto masa janë të defnuara në Nenin 146, paragrafi (1), të Ligjit për procedurë penale – tekst i pastruar („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 15/2005). Për ta mund të merret autorizim nga gjykatësi hetues ose prokurori publik dhe mund të zbatohen në hetimet kriminale. Në mënyrë plotësuese, Ligji për ndjekjen e komunikimeve nga viti 2006 (Neni 29) i jep mundësi Ministrisë së punëve të brendshme dhe Ministrisë së mbrojtjes, me vendimin paraprak të Gjyqit suprem, t’i ndjekin komunikimet e personit për të cilin ekzistojnë baza për dyshim se përgatit kryerje të veprës penale kundër shtetit, kundër forcave të armatosura ose kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare. Përveç kësaj, mund të urdhërojë ndjekje të komunikimeve edhe kur përgatitet, nxitet, organizohet ose merr pjesë në sulme të armatosura kundër Republikës së Maqedonisë ose në paaftësimin e sistemit të saj të sigurisë.

Përveç këtij konflikti, institucionet përgjegjëse për kontrollin demokratik mbi shërbimet e sigurisë-zbulimit (si për shembull komisionet parlamentare), kryesisht kanë treguar mangësi të vullnetit politik që të kërkojnë përgjegjës nga agjensionet përkatëse për punën e tyre.

Qëllimi kryesor i këtij studimi, i cili përfshin periudhën prej vitit 1991 e deri më 2011, është që, në mënyrë kritike, të vlerësojë se sa kanë bërë aktorët në sektorin e sigurisë-zbulimit në raport me kontrollin e tyre demokratik (qytetar). Studimi e përshkruan sistemin e tanishëm për mbikëqyrje dhe flet për perspektivat për implementimin e reformave në të njëjtën. Së fundi, studimi identifikon mangësitë kyçe në sistemin aktual dhe jep rekomandime për përmirësimin e tyre.

2. Organizimi i shërbimeve të sigurisë-zbulimit

2.1 Gjendja

Edhe pse Maqedonia arriti t'i shmanget luftërave të cilat i kapluan republikat tjera të Jugosllavisë së dikurshme dhe u bë shtet i pavarur në rrugë të qetë, megjithatë, pas shthurjes së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në vitin 1991, u ballafaqua me provokime shumë të mëdha në planin e sigurisë. Në atë periudhë jashtëzakonisht të rëndë, vendi u detyrua ta rishikojë dhe sërish ta ndërtojë sistemin e vet të sigurisë, duke përfshirë edhe shërbimet e sigurisë-zbulimit.

Disa ngjarje kyç ndikuan në orientimin dhe dinamikën e këtij procesi. Më i theksuar ishte tentimi për atentat mbi kryetarin Kiro Gligorov, në vitin 1995, që ngriti çështjen për kualitetin e punës të shërbimeve të sigurisë-zbulimit. Si pasojë e kësaj krize, bashkësia maqedonase e zbulimit u riorganizua në dy organe të reja: Agjensioni për zbulim (AZ), organ i pavarur i ngarkuar për hulumtimin e kërcënimeve të cilat vinë nga jashtë,⁶ dhe Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim (DSK), njësi e Ministrisë së punëve të brendshme (MPB) e ngarkuar për hulumtimin e kërcënimeve të cilat vijnë nga brenda.⁷ Paraprakisht, me Ligjin për mbrojtje të vitit 1992 u themelua Sektori-Shërbimi për siguri ushtarake dhe zbulim (SShSUDheZ) në kuadër të Ministrisë së mbrojtjes (MM). Kjo strukturë bazë edhe më tej ekziston.

Vendimi që kundërzbulimi të ndahet në DSK (dhe në këtë mënyrë të vëhet nën kontroll të MPB) ishte zgjidhje jo e zakonshme. Më shumë programe për reforma në Evropën Juglindore, zgjodhën që kundërzbulimin ta konsiderojnë në kuadër të trupave të pavarur, të cilat përgjigjen direkt para Qeverisë dhe nuk janë pjesë e asnjë ministrie.

Kryetarit të Maqedonisë iu dhanë autorizime të gjëra mbi Agjencionin për zbulim, duke përfshirë edhe të drejtën ta emërojë dhe shkarkojë drejtorin e tij, nëse konsideron se ekziston nevoja për atë. Më tutje, Agjensioni për zbulim duhet të dërgojë raport, direkt deri te Kryetari, dhe më pastaj t'i dorëzojë informacionet edhe deri te trupat tjera qeveritar. Kjo

⁶ Edhe pse Kuvendi i Maqedonisë e miratoi Ligjin për agjencionin për zbulim në vitin 1995, AZ nuk filloi me punë deri në vitin 1997.

⁷ Para këtij ndryshimi, detyrat për zbulim dhe kundërzbulim i kryente Shërbimi për siguri shtetërore në kuadër të Ministrisë së punëve të brendshme.

reformë u realizua që të baraspeshohen kompetencat në mes të degëve të ndryshme të pushtetit ekzekutiv, ashtu që asnjë ministri nuk do të kishte kontrollë mbi zbulimin. Më tutje, me ndarjen e detyrave për zbulim dhe kundërzbulim në mes të tri shërbimeve të ndryshme, krijuesit e këtij sistemi shpresonin se do ta nxisin diverzifikimin e burimeve të informacioneve.

Në fillimin e viteve të 2000-ta, sërish u ndezën kritikrat nga opinioni për shërbimet e sigurisë-zbulimit, drejtpërdrejtë të nxitura nga lufta në Kosovë në vitin 1999, e shoqëruar me krizën e refugjatëve; konflikti i armatosur në Maqedoni;⁸ dhe disa ngjarje kontraverse në vend, nga të cilat më e theksuar ishte afera për përgjim “Veshi i madh”. Përveç debatimeve rreth efektivitetit të shërbimeve të sigurisë-zbulimit, opinioni i vuri nën pikëpyetje edhe kualitetin e punës së tyre në lidhje me procesin e vendosjes, si dhe në çfarë mase Qeveria kryen mbikëqyrje adekuate mbi shërbimet. Debatet zbuluan disa mangësi thelbësore në sistem, veçanarisht mangësinë e rrjedhës së informacioneve dhe kualitetin e dobët të informacioneve tashmë të dorëzuara. Në vend që të përmirësohet kualiteti i informacioneve, me diversifikimin e burimeve, përmes ndarjes së detyrave të punës në mes të tri shërbimeve të zbulimit, të cilat u vunë nën kompetencë të ndryshme, erdhi deri te polarizimi i shërbimeve dhe bashkëpunimi i ndërsjellë ishte i dobët. Në vitin 2003, i punësuar në Agjensionin për zbulim e i ilustronte situatën, me komentim në opinion, se Agjensioni për zbulim dhe DSK “kursesit nuk komunikojnë”.⁹

Megjithatë, sfida të caktuara lidhur me zbulimin mbetën të pandryshuara, para se gjithash ato të lidhura me profesionalizmin e shërbimeve (d.m.th. mungesë të profesionalizmit). “Pa dallim se cila parti politike vinte në pushtet, qëllimi kryesor i tij është që të merr kontrollin e tërësishëm mbi trupat e vet”, siç deklaroi funksionari i dikurshëm i lartë i SShSU dhe Z. “Konsiderohet krejtësisht ‘normale’ që partitë politike ta shfrytëzojnë atë mundësi që t’i keqpërdorin këto trupa për përfitim të vetin personal.”¹⁰ Një marrëdhënie e tillë e nxit mosbesimin të cilin anëtarët e koalicionit në pushtet e kanë ndaj të punësuarve në shërbimet e zbulimit, ose për shkak të asaj që të punësuarit kanë lidhje të ngushta me anëtarët e partive opozitare apo për shkak se ata tashmë njëherë i kanë shërbyer liderëve të partive opozitare kur ata ishin në pushtet.

Gjithsesi, sjellja e tillë ka efekt të fuqishëm negativ mbi kuadrin e shërbimit konkret të sigurisë-zbulimit. Çdo herë kur ndërrohet qeveria dhe kur parti e re e merr pushtetin, pjesa më e madhe e kuadrit ndërrohet, e me të humbet dituri me vlerë e nxënë përmes trajnimeve dhe përvojës. Për shembull, në vitin 2006, ndryshimi i pushtetit solli deri te emërimi i drejtorit të ri të DSK, i cili menjëherë pastaj i shkarkoi drejtorët e të gjithë pesë njësisive në

⁸ Për analizën më të detajuar të konfliktit të armatosur në vitin 2001, shih Grupi ndërkombëtar i krizës: Raporti nr. 109, *Çështja maqedonase: Reformë ose kryengritje*, 5 prill të vitit 2001. (i arritshëm në: <http://www.crisisgroup.org/en/regions/europe/balkans/macedonia/109-the-macedonian-question-reform-or-rebellion.aspx>)

⁹ S. K. Delevska, „Zbuluesit maqedonas të përçarë.” *Vest*, 18 gusht të vitit 2003. (i arritshëm në: <http://star.vest.com.mk/default.asp?id=65408&idg=4&idb=934&rubrika=Makedonija>)

¹⁰ Intervistë me funksionarin e dikurshëm të lartë të SShSU dhe Z, në 10 mars të vitit 2011.

Shkup dhe i shpërndau në stacione të ndryshme policore si inspektorë.¹¹ “Në vend që të vazhdojmë ta punojmë atë për të cilën jemi trajnuar, për kundërzbulim”, u ankua njëri nga drejtorët e shkarkuar, “tani duhet gjithsesi të ballafaqohemi me krimin, me xheparoshllëkun dhe me kundërvatjet e të rinjve, diçka që më parë nuk e kemi bërë.”¹²

Ky lloj i udhëheqjes së gabuar shkon dorë për dorë me procedurën e politizuar të emërimit të drejtorëve të shërbimeve të sigurisë-zbulimit. Nga viti 1995 e këndeje, ekzistojnë kritika të mëdha nga opinioni për zgjedhjen të cilën e bënë kryetarët e ndryshëm, rreth asaj se cili të emërohet në pozitën e drejtorit të Agjensionit për zbulim dhe, në masë më të vogël, për zgjedhjen e drejtorit të DSK. Pothuajse në të gjitha rastet, personat të cilët u emëruan t'i udhëheqin këto shërbime ishin ngushtë të lidhur me partitë politike. Për shembull, paradokohe, drejtori i DSK merrte pjesë në bisedimet në mes të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (OBRM-PDUKM¹³) e cila fitoi në zgjedhjet në qershor të vitit 2011 dhe Partisë Demokratike për Integrim (BDI¹⁴), parti e Shqiptarëve etnik, të cilat i paraprinë marrëveshjes për lidhjen e koalicionit qeverisës.¹⁵ Imponimi i partive politike në punën e shërbimeve të sigurimit-zbulimit, të cilat janë rezultat i përkatësisë politike të nëpunësve nga rangu më i lartë, pakëndshëm ndikon mbi kualitetin e punës së shërbimeve të zbulimit dhe e degradon profesionalitetin e institucioneve.¹⁶

Problem i ngjajshëm është edhe keqpërdorimi i pasurisë, gjegjësisht pajisjeve të shërbimeve të sigurisë-zbulimit, nga ana partive në pushtet, me qëllim që ta forcojnë pozicionin e vet, në llogari të partive opozitare. Dy ngjarje veçanarisht e tërhoqën vëmendjen e medimeve dhe opinionit. I pari, në vitin 1992, afëra “Strofulla”, në të cilën u përfshi partia e dikurshme në pushtet, Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM)¹⁷, e cila akuzohej për shfrytëzimin e pajisjes së MPB që ta përgjojë rivalin e vet më të madh politik, OBRM-PDUKM.¹⁸ I dyti, në vitin 2001, afëra “Veshi i madh”. Kësaj rradhe, anëtarët e LSDM (tani në opozitë), së bashku me disa gazetarë dhe liderë të organizatave të shoqërisë civile, kinse ishin viktimë të përgjimit dhe formave tjera të vëzhgimit.¹⁹ Gjithsesi, këto dy afëra e potencuan nevojën për mbikëqyrje efikase dhe kontroll mbi bashkësinë e zbulimit

¹¹ E.Z. „U shkarkuan kryeshefat e Shkupit të DSK.” *Vreme*. 17 shtator i vitit 2006. (i arritshëm në <http://www.vreme.com.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=12&tabid=1&EditionID=863&ArticleID=57378>)

¹² Z. K. – D. T. „Pastrime partiake në MPB i të papërshtshmeve.” *Utrinski vesnik*. 16 tetor i vitit 2006. (i arritshëm në <http://star.utrinski.com.mk/?pBroj=2190&stID=77367&pR=2>)

¹³ Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas

¹⁴ Bashkimi Demokratik për Integrim

¹⁵ M.T. – T.P. „Mijalkov dhe Ademi i udhëheqin bisedimet për qeverinë e re.” *Dnevnik*. 15 qershor i vitit 2011. (i arritshëm në

<http://www.dnevnik.com.mk/default.asp?ItemID=463DB859FE3FCA4AAAB40E4F2D2BCF9E>)

¹⁶ Venco Donçev, „Pastrim i ushtarëve partiak në shërbimet e sigurisë.” *Nova Makedonija*. 12 qershor i vitit 2009. (i arritshëm në

<http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=612933830155&id=9&setIzdanie=21710>)

¹⁷ Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë

¹⁸ Shenimet stenografike, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Prill, viti 1993. Faqja 22. (i arritshëm në: <http://www.sobranie.mk/WBStorage/Files/56sednica7prod21april93god.pdf>)

¹⁹ U. V. „Aktgjykimi i parë për ‘Veshi i madh’, gazetarët e fituan procesin lidhur me përgjimin.” *Utrinski vesnik*. 16 qershor i vitit 2007. (i arritshëm në:

<http://www.utrinski.com.mk/?ItemID=78934BEAF767214D9A4F2E2C4CE439EF>)

2.2 Agjensioni për zbulim (AZ)

Pas shpalljes së pavarësisë, Maqedonia i bashkoi agjensionet e veta civile për zbulim, në kuadër të një institucioni – MPB-së. Një rregullim i tillë ekzistonte deri në vitin 1995, kur me Ligjin për Agjensionin për zbulim u themelua Agjensioni për zbulim (AZ).²⁰ Që nga atëherë, ligji nuk është ndryshuar, edhe pse Gjyqi kushtetues i abrogoi disa dispozita.²¹ Njëra nga to, të punësuarve në AZ ua shkurtonte të drejtën për grevë kundër vendimeve të drejtorit të AZ, gjatë miratimit të dispozitave nënligjore për rregullat e punës së AZ. Dispozita u shpall jokushtetuese. E njëjta ndodhi edhe me dispozitën me të cilën, qytetarëve të cilët ishin të akuzuar ose dënuar për vepra penale kundër rregullimit kushtetues ose sigurisë së Maqedonisë, iu ndalohej punësimi në AZ.²²

Ligji për Agjensionin për zbulim, ku rregullohet puna në AZ, nuk është mjaft i detajuar. Me nenin 2 rregullohet se “Agjensioni është përgjegjës në mbledhjen e dhënave dhe informacioneve të rëndësishme për sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës së Maqedonisë dhe interesave ekonomike, politike dhe interesave të tjera të shtetit.”²³ Ligji, gjithashtu, imponon që Agjensioni detyrueshëm të dorëzojë raport deri te kryetari. Më tutje, lejohet që edhe organet tjera shtetërore të marrin informacione dhe analiza nga AZ, për çështje me rëndësi për sferën e tyre të veprimit. Dhe, me të vërtetë, shumë prej tyre, marrin raporte të tilla, çdo javë. Mirëpo, në lidhje me funksionet tjera, AZ do të ishte më efikas nëse do të kishte mandat më të qartë ligjor, veçanarisht në aspektin e interaksionit me shërbimet tjera të sigurisë-zbulimit.

AZ ishte krijuar si trup i pavarur, i nënshtruar para kryetarit. Mirëpo, ekzistojnë disa fusha të kompetencave të cilat i lejojnë Qeverisë, në mënyrë direkte, të ndikojë mbi punën e AZ. Këtu bëjnë pjesë miratimet të lidhura me kuadrin, si dhe aprovimi i metodave dhe mjeteve të AZ.²⁴ Në mënyrë plotësuese, Qeveria mund të kërkojë përgjegjësi nga drejtori i AZ për punën e vet dhe ka kontroll mbi buxhetin e agjensionit.

2.3 Drejtorja për siguri dhe kundërzbulim (DSK)

Edhe pse mandati dhe kompetencat e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dalin nga Ligji për punë të brendshme nga viti 1995, DSK, nga aspekti organizativ, paraqet bashkim të njësive tashmë ekzistuese në MPB, Nga atëherë, Ligji për punë të brendshme pësoi disa

²⁰ Ligji për Agjensionin për zbulim. “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 19/1995.

²¹ Vendimet e Gjyqit kushtetues nr. 76/2000 dhe 211/2000.

²² Në AZ janë të punësuar më shumë veteranë nga sistemi për zbulim i Jugosllavisë së dikurshme.

²³ Ligji për Agjensionin për zbulim. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 19/1995). Neni 2.

²⁴ Ibid. Neni 13.

ndryshime, kurse për herë të fundit në vitin 2009.²⁵ Në të, fushat që pasojnë janë vu në dukje si kompetenca të DSK: ²⁶

- kundërzbulimi;
- terrorizmi;
- aktivitetet të cilat i kërcënojnë institucionet demokratike të vendit ose mbështesin mospranimin e tyre të dhunshëm;
- krimi i organizuar i cili rrjedh nga ose është i drejtuar drejt institucioneve demokratike të vendit.

Gjatë punës së vet, DSK, me lejen paraprake të gjyqtarit hetues, prokurorit publik ose gjyqtarit suprem²⁷, mund të shërbehet me masa hetuese speciale, si përgjimi, mbikëqyrja e fshehtë, kryerje të bastisjes në pronën private dhe shfrytëzimi i identitetit të rremë. Gjithashtu, një pjesë e të punësuarve në DSK kanë edhe autorizime policore, duke përfshirë edhe përdorimin e armës së zjarrit dhe autorizimin për arrestim.²⁸

Në raportin për vitin 2006, Komiteti evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor dhe degradues, deklaroi se DSK, në disa raste, shfrytëzoi objekte të paligjshme për paraburgim, për qëllimet lidhur me punën e tyre.²⁹ Praktika e tillë i then normat ligjore, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare, nënshkruese e të cilave është Maqedonia. Gjithashtu, paraqet shkelje të vrazhdë të të drejtave të njeriut. Edhe përrreth dëshmisë bindëse me të cilën qartë përshkruhet kryerja e torturës në këto objekte, DSK me vendosmëri i hodhi të gjitha akuzat.

Si edhe shërbimet tjera të sigurisë-zbulimit (duke përfshirë edhe AZ), DSK ngadonjëherë nuk arrin me kohë, as në mënyrë efikase, të reagojë në kërcënimet reale dhe potenciale mbi sigurinë. Për shembull, kryeministri i dikurshëm Vlado Buçkovski, në mënyrë publike, deklaroi se “DSK ka pasur informacione për grupin prej tetë personave të panjohur të armatosur i cili ka kaluar në afërsi të Shkupit”³⁰, mirëpo ky informacion së shpejti u demantua nga ana e kabinetit të kryetarit. Më tutje, mungesa e koordinimit në mes të DSK dhe AZ, të cilët rrallë shkëmbejnë informacione, është lëshim në sistem për të cilin duhet të gjendet zgjidhje.

²⁵ Ligji për punë të brendshme. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 92/09).

²⁶ Ibid. Neni 16.

²⁷ Gjyqi suprem mund të jep leje për ndjekjen e komunikimeve për vepra të cilat janë të theksuara në nenin 29 të Ligjit për ndjekjen e komunikimeve. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 121/2006).

²⁸ Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim kryen ndjekje të komunikimeve për raste të lidhura me sigurinë dhe mbrojtjen e vendit, siç është e theksuar në Ligjin për ndjekjen e komunikimeve (neni 29 – 40). Për veprat tjera penale, të përcaktuara me Ligjin për ndjekje të komunikimeve (neni 8), masat për ndjekje të komunikimeve realizohen nga Njësia për krimin të organizuar, në kuadër të Ministrisë së punëve të brendshme. Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë – Misioni vëzhgues në Shkup, *Masa speciale hetuese* (viti 2010): 19, 22. (i arritshëm në: <http://www.osce.org/skopje/78152>)

²⁹ Komiteti evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor dhe degradues. *Raport deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë mbi vizitën në Republikës së Maqedonisë nga ana e Komiteti evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor dhe degradues (KPT) prej 15 deri më 26 maj të vitit 2006* (viti 2008): 22. (i arritshëm në: <http://www.cpt.coe.int/documents/mkd/2008-05-inf-eng.pdf>)

³⁰ Momir Serafinoviq, „Askush nuk i kontrollon shërbimet sekrete maqedonase.“ *AItelevizioni*. 12 janar i vitit 2006. (i arritshëm në: <http://www.al.com.mk/vesti/default.aspx?VestID=56827>)

Mënyra se si opinioni e përcepton DSK ndikohet fuqishëm nga rezultatet problematike, që janë pasojë e përdorimit nga ana e saj e masave speciale hetuese dhe autorizimeve policore. Edhe në të dy aferat, “Strofulla” dhe “Veshi i madh”, ishin të përfshira aktivitete të kryera nga njësitë e DSK.

2.4 Sektori- Shërbimi për siguri ushtarake dhe zbulim (SShSUDheZ)

I vendosur në kuadër të Ministrisë së mbrojtjes, SShSUDheZ morri mandat dhe kompetencë për sjelljen e Ligjit për mbrojtje, në vitin 1992³¹, i cili ishte ndërruar me Ligjin për mbrojtje, në vitin 2001, ku më detajisht është arsyetuar veprimi i tij.³²

Kur Agjensioni për zbulim filloi me punë më 1997, segmenti i zbulimit i SShSUDheZ u zhvendos në këtë shërbim të sigurisë-zbulimit, kurse njësia për kundërzbulim mbeti në kuadër të MB. Mirëpo, sipas një funksionari të dikurshëm të lartë të SShSUDheZ, “Struktura e tillë nuk tregoi rezultate të kënaqshme, andaj zbulimi ushtarak u kthye në MM”.³³

Si shtesë e njësive për zbulim dhe kundërzbulim, në SShSUDheZ është përfshirë edhe njësia administrative për analizë, logjistikë dhe financa, si dhe njësia hetimore, në kompetencë të së cilës janë aktivitetet kriminale. SShSUDheZ është gjithashtu i autorizuar t’i ndjek komunikimet për veprat të cilat i përkasin forcave të armatosura dhe shtetit (sulmi i armatosur kundër shtetit ose kundër sistemit të tij të sigurisë).³⁴ Mirëpo, me Ligj është përcaktuar se SShSUDheZ mund të veprojë vetëm në radiovalët që vijnë (frekuencat e larta - HF, frekuencat mjaft të larta – VHF dhe frekuencat ultra të larta – UHF) të cilat janë karakteristikë veçanarisht për nevojat e mbrojtjes. Edhe pse policia ushtarake maqedonase i përgjigjet Shtabit të Përgjithshëm, ata gjithashtu i ndihmojnë SShSUDheZ. Ministri për mbrojtje e emëron shefin e SShSUDheZ, i cili përgjigjet para ministrit dhe para kryetarit. Në rast se Maqedonia merr pjesë në misione ndërkombëtare të paqës të karakterit ushtarak, SShSUDheZ kontribuon me kuadrin e vet.

Siç është e përcaktuar me Ligjin për mbrojtje nga viti 2001, fushëveprimi i punës i SShSUDheZ përfshin:³⁵

- mbledhjen, dokumentimin dhe analizimin e të dhënave të zbulimit, të rëndësishme për mbrojtjen kombëtare;
- zbulimin dhe pengimin e aktiviteteve subverzive të cilat dalin nga agjensionet e huaja të zbulimit ose grupet tjera ndërkombëtare (si organizatat terroriste), të rëndësishme për mbrojtjen kombëtare;
- mbrojtjen e forcave të armatosura;
- mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara.

³¹ Ligji për mbrojtje. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 8/92“). Neni 119,

³² Ligji për mbrojtje. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 42/2011). Neni 133.

³³ Intervistë me funksionarin e dikurshëm të lartë të SShSUDheZ, në 10 mars të vitit 2011.

³⁴ Ligji për ndjekjen e komunikimeve, neni 29 dhe 30. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 121/2006).

³⁵ Ligji për mbrojtje. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 42/2011). Neni 133.

2.5 Bashkëpunimi në mes të agjensioneve për zbulim

Kontributi i shërbimeve të sigurisë-zbulimit gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2001, qartë tregoi se bashkëpunimi në mes të shërbimeve është në nivel të ulët. Sipas Lupço Stefkovskit, i punësuar në AZ, “kriza e luftës në vitin 2001 i gjeti strukturat e sigurisë të pandërtuara. Ato funksionuan në mënyrë segmentare, të interesuar kryesisht për vete, se sa për sigurinë e përgjithshme kombëtare, pa koordinim dhe bashkëpunim.”³⁶ Stefanovski, gjithashtu, zbuloi se ka ndodhur “shumë shpesh, shfrytëzuesit primar [të zbulimit] — kryetari, kryeministri, ministrat për mbrojtje, për punë të brendshme, për punë të jashtme – të marrin ose të posedojnë me informacione diametralisht të ndryshme, për ngjarje të caktuara të sigurisë, ose për vlerësime të ngjajshme, por të marra në periudhë të ndryshme kohore.”³⁷

Marrëveshja nga viti 2003 në mes të shërbimeve të sigurisë-zbulimit i obligon të njejtët të mbajnë mbledhje javore dhe të paraqesin raport të përbashkët deri te udhëheqësia politike maqedonase. Mirëpo, sipas një funksionari të AZ, i cili ishte intervistuar për këtë studim, mbledhjet javore nuk janë dëshmi për bashkëpunim të veçantë: “Çdo herë, vetëm njëra anë shkëmben më shumë të dhëna, kurse të tjerët nuk dëshirojnë ta bëjnë atë. Përveç kësaj, të dhënat të cilat shkëmbehen në këto mbledhje kalojnë nëpër më shumë filtra, para se të vendosen në tavolinë.”³⁸

Në nivel ndërkombëtar, Maqedonia nënshkroi marrëveshje për bashkëpunim në fushën e zbulimit me katërdhjetë vende, para se gjithash në Evropë (duke përfshirë të gjithë fqinjët nga Evropa Juglindore), por edhe me vendet nga Lindja e Mesme dhe nga Evroazia.³⁹ Shkalla dhe mënyra e bashkëpunimit me secilin agjension, në mënyrë specifike e përcaktojnë shërbimet dhe funksionarin të cilit ai/ajo i paraqet raport. Maqedonia, në këtë moment, merr pjesë në Konferencën për shërbimet e sigurisë dhe zbulimit të Evropës Juglindore dhe punon në drejtim të marrjes së anëtarësimit të plotë në Konferencën e Evropës Qendrore (në të cilën, në këtë moment, ka vetëm status të vëzhguesit).⁴⁰

Shërbimet e huaja të zbulimit, veçanarisht ata të SHBA dhe Mbretërisë së Bashkuar, në mënyrë aktive e ndihmuan Maqedoninë në përgatitjen e ligjit të ri, me të cilin duhet më detajisht të rregullohen të gjitha shërbimet e saja që ofron për siguri-zbulim.⁴¹ Në ndërkohë, DSK u përfshi në Planin aksional të partneritetit kundër terrorizmit (PAP-T), ku vendet e Organizatës së traktatit të atlantikut (NATO) dhe aleatët e tyre e shkëmbejnë praktikat më të mira për luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar.

³⁶ „Elitat politike edhe më tej i shikojnë shërbimet e zbulimit si instrument për qërim hesapesh ndërpartiake.”

Radio Evropa e lirë. 3 qershor i vitit 2007. (i arritshëm në: <http://www.makdenes.org/content/article/1483411.html>)

³⁷ Ibid.

³⁸ Intervistë me funksionarin e AZ, në 18 gusht të vitit 2011.

³⁹ Ibid.

⁴⁰ Të dy konferencat i bashkojnë shërbimet e sigurisë dhe të zbulimit, me qëllim që të bisedohet për më shumë pyetje të lidhura me interese të përbashkëta. Shërbimet shkëmbejnë informacione për kushtet vijuese, si dhe për strukturën dhe për metodat e punës.

⁴¹ Miomir Serafimoviq. „CIA ndihmon për ligjin maqedonas për shërbimet sekrete“. *Kanal 5*. 21 shtator i vitit 2010. (i arritshëm në: <http://www.kanal5.mk/default.aspx?mld=37&egld=13&eventId=65083>)

3. Ndryshimet e propozuara në sektorin e sigurisë-zbulimit

Në fund të vitit 2010, ministri për punë të brendshme shpalli se Qeveria së shpejti do të propozojë ndryshime të konsiderueshme për shërbimet maqedonase të sigurisë-zbulimit.⁴² AZ dhe DSK do të jenë ato shërbime të cilat do të kryhen ndryshime më të mëdha. Edhe pse ligji i ri edhe më tej është në draft dhe detajet ende nuk janë të nxjerra në opinion, Qeveria shpalli se do të propozojë që AZ dhe DSK të bashkohen në një Agjension për zbulim dhe kundërzbulim civil. Sipas Qeverisë, qëllimi kryesor i bashkimit është që të përmirësohet grumbullimi dhe shkëmbimi i të dhënave të zbulimit. Gjithashtu, puna e shërbimit të vetëm të unifikuar do të kushtojë shumë më pak.

Shërbimi i ri, siç thuhet, do të ishte nën ingerencë të Qeverisë. Kjo nënkupton se kryetari do të humb më së shumti me rregullimin e ri, duke heq dorë nga kontrolli i vet mbi një aspekt me rëndësi për makinerinë kombëtare të sigurisë, e kjo do ta linte pa burim “të pavarur” të informacioneve. Mirëpo, kryetari edhe më tej nuk u deklarua lidhur me propozimin. Nga ana tjetër, madje të punësuarit në AZ e kundërshtuan bashkimin e propozuar, përmes deklaratës në opinion, ku i theksojnë marrëdhëniet e dobëta në mes të AZ dhe DSK:

*Është e saktë se, nga viti i kaluar e këndej, AZ ballafaqohet me sulme nga DSK dhe MPB, të cilët plotësisht e nënvlerësojnë AZ. Është e vërtetë edhe se ata i kufizuan resurset tona financiare dhe i shpiten në minimum dhe se me metodat e tilla ata dëshirojnë në masë të konsiderueshme të kufizojnë punën e AZ dhe në fund ta mbyllin.*⁴³

Gjithsesi, Maqedonia kishte shërbim të tillë civil të unifikuar të zbulimit, para vitit 1995, kur u soll vendimi që funksionet e shërbimit të ndahen në mes të AZ dhe DSK.

4. Organet për mbikëqyrje

Sistemi maqedonas ligjvënës mundëson që disa organe për mbikëqyrje, direkt ose indirekt, ta kontrollojnë punën e shërbimeve të sigurisë-zbulimit. Në këtë studim hulumtohet puna e organeve për mbikëqyrje të jashtme, sepse vargu i mekanizmave të ndryshëm të kontrollit me të cilat ata posedojnë, detajisht e mbulon rrethveprimin e tërësishëm të mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi bashkësinë e sigurisë-zbulimit në Maqedoni. Në mënyrë plotësuese, fakti se trupat për mbikëqyrje të jashtme duhet patjetër të përgjigjen para opinionit për punën e vet, e bënë hulumtimin e tyre më të besueshëm.

Studimi do t'i hulumtojë institucionet për mbikëqyrje të jashtme si vijon:

⁴² Slavica Arsova. „Dy shërbime të zbulimit me ligjin e ri.” *Sitel*. 29 shtator i vitit 2010. (i arritshëm në: <http://www.sitel.com.mk/dnevnik/makedonija/dve-razuznavachki-sluzbi-so-noviot-zakon>)

⁴³ „Zbuluesit ndahen në civil dhe ushtarak.” *Vreme*. 24 shtator i vitit 2010. (i arritshëm në: <http://www.vreme.com.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=1&ArticleID=148938&EditionID=2128>)

Avokati i popullit;
Kuvendi;
Gjyqësori;
Këshilli i sigurisë kombëtare;
Enti shtetëror për revizion.

4.1 Avokati i popullit

Baza ligjore për punën e Avokatit të popullit del nga neni 77 i Kushtetutës së Maqedonisë, me të cilën Avokati i popullit autorizohet “t’i mbrojtë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve, të cilat u janë cenuar nga ana e organeve të administratës shtetërore dhe nga organet e organizatat tjera të cilat kanë autorizime publike.”⁴⁴

Të gjithë qytetarët kanë të drejtë të parashtrijnë ankesë deri te Avokati i popullit, të cilin e zgjedh Kuvendi, i cili i jep mandat prej tetë vitesh, me të drejtë rizgjedhje. Avokati i popullit ka autorizim që vetë të ngrit hetim, nëse dyshon se ka ardhur deri te çfarëdo keqpërdorimi. Kjo është e një rëndësie të veçantë kur bëhet fjalë për punën e shërbimeve të sigurisë-zbulimit, për shkak të masave speciale hetuese me të cilat ata do të shërbehen dhe për autorizimet policore me të cilat disa nga të punësuarit posedojnë.

Drejtori i dikurshëm i DSK, Goran Mitevski, gjatë një interviste në televizionin kombëtar, fliste për keqpërdorimet dhe deklaroi se deri te keqpërdorimi arrihet kur përfaqësuesit e DSK sjellin persona në stacionin policor, më së shpeshti pa u njoftuar paraprakisht për këtë Biroja për siguri publike (sektor i ngarkuar për policinë pranë Ministrisë së punëve të brendshme). Sipas tij, për një pjesë të këtyre të dyshuarve nuk ekziston evidencë se janë sjellur.⁴⁵

Prej andej, Avokati i popullit, edhe përkundër mandatit të vet dhe autorizimeve me rëndësi, nuk kryen mbikëqyrje të mjaftueshme mbi shërbimet e sigurisë-zbulimit. Të paktën, nga viti 2008 e këndej, ai nuk ka kryer vizita parandaluese në teren (për shembull, vizitë të DSK).⁴⁶

Interesante është që neni 20 i Ligjit për Avokatin e popullit i definoi rrethanat në të cilat Avokati i popullit *nuk* është i detyruar të ngrit hetim – “po që se nga parashtrësia konstatohet se punohet për rast më pak të rëndësishëm, i cili edhe pas hetimit të kryer nuk

⁴⁴ Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë. Neni 77. (i arritshëm në <http://sobranie.mk/?ItemID=A431BEE83F63594B8FE11DA66C97BEAF>)

⁴⁵ Katerina Geteva. „Zbuluesit e ri do të fitojnë autorizime të reja policore“ *Al televizioni*, 28 shtator i vitit 2010.

⁴⁶ Informacione nga Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë, të marra përmes shfrytëzimit të së drejtës për qasje deri te informacionet me karakter publik. Vërejtje: Informacionet e marra nuk i përkasin periudhës deri në vitin 2008.

mund të japë rezultate përkatëse.⁴⁷ Me fjal tjera, Avokati i popullit ka të drejtë diskrete të vendosë se rasti i caktuar a është i ndonjë rëndësie apo jo.

Nëse Avokati i popullit vendos të mos ngritë procedurë për parashtresë, ai është i obliguar ta informojë parashtruesin e parashtresës dhe sipas mundësisë t'ia sqarojë arsyet për të cilat të njejtën e ka refuzuar. Pastaj, parashtruesi i parashtresës mund të dorëzojë ankesë deri te Gjyqi kushtetues, i cili gjithashtu ka kompetencë në domenin e lëndimit e të drejtave njerëzore.⁴⁸

Në lidhje me kompetencat, Avokati i popullit është kompetent t'i obligojë institucionet publike të dorëzojnë informacione dhe sqarime të detajuara në lidhje me ankesat. Të gjithë nëpunësit shtetëror (duke përfshirë drejtorët e AZ, DSK dhe SShSU dhe Z) obligueshëm duhet të prononcohen në lidhje me rastet, pa marrë parasysh shkallën e klasifikimit të informacioneve të kërkuara.

Në çdo rast, të dhënat në disponim (nga viti 2008 e deri më vitin 2011) tregojnë se Avokati i popullit nuk ka kërkuar qasje deri te çfarëdo qoftë informacioni i klasifikuar nga shërbimet e sigurisë-zbulimit.

Pasi Avokati i popullit të vendos se kemi të bëjmë me kundërvatje, ai/ajo ka të drejtë që:

- të propozojë për largimin e pengesës apo pengesave të gjetura;
- të inicojë procedure disiplinore;
- të kërkojë nga prokurori publik të fillojë hetim penal.

Institucionet shtetërore obligohen të dërgojnë raport kthyes deri te Avokati i popullit në lidhje me realizimin e rekomandimeve të tij/asaj. Në qoftë se nuk e bëjnë atë, Avokati i popullit mund ta lajmërojë Qeverinë dhe Parlamentin se të njejtët refuzojnë të bashkëpunojnë.

Avokati i popullit dorëzon raport vjetor për punën e tij deri në Kuvend, kurse raporti është në dispozicion për opinionin dhe prezentohet gjatë kohës së mbledhjeve plenare të Kuvendit, ku marrin pjesë përfaqësues të Qeverisë. Në raportin vjetor të Avokatit të popullit nuk tregohen aktivitete, në cilën do mënyrë, lidhur me punën e shërbimeve të sigurisë-zbulimit. Deri më tani, Avokati i popullit vetëm një herë ka marrë masa në domenin e punës së shërbimeve të sigurisë-zbulimit. Në vitin 2000, Avokati i popullit rekomandoi që Kuvendi t'i ndryshojë dispozitat ligjore me të cilat ngadalësohet procesi i pranimit të informacioneve në lidhje me kualifikimin e aplikantëve për marrjen e shtetësisë. (DSK luan rol me rëndësi në këtë proces, me atë që bëjnë verifikimin e sigurisë për personat që aplikojnë për shtetësi, kurse paraqesin kërcënim për sigurinë e shtetit). Në vitin 2004, Kuvendi kreu ndryshim të Ligjit për shtetësi, me rekomandim të Avokatit të popullit.

Njëra nga arsyet për mungesë të aktivitetit në lidhje me shërbimet e sigurisë-zbulimit është vetëdija e përgjithshme e ulët për rolin e Avokatit të popullit. Arsye tjetër mund të jetë

⁴⁷ Ligji për Avokatin e popullit. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 60/2003). Neni 20. (i arritshëm në <http://www.ombudsman.mk/default.aspx?cId=100&Lan=EN>)

⁴⁸ Rregullorja për punë e Gjyqit kushtetues të Republikës së Maqedonisë. Neni 51.

edhe ajo që masat speciale hetuese, në parim janë sekrete dhe kështu grupi i qëllimit nuk është i vetëdijshëm për përdorimin e të njejtave. Si arsye e tretë mund të theksohet edhe fakti se një pjesë e ankesave të cilat i dedikohen DSK, në vend që të dorëzohen deri Avokati i popullit, ato dorëzohen deri te Sektori për kontroll të brendshëm dhe standarde profesionale, i cila funksionon si mekanizëm i brendshëm i kontrollit pranë MPB. Në çdo rast, te Avokati i popullit nuk ekziston vullnet për veprim proaktiv dhe mbikëqyrje në lidhje me shërbimet e sigurisë-zbulimit.

4.2 Kuvendi

Edhe Kuvendi, si në rastin me Avokatin e popullit, nuk arriti në mënyrë konsekuente ta realizojë mbikëqyrjen mbi shërbimet e sigurisë. Edhe përkundër ekzistimit të më shumë strukturave juridike, të dhënat tregojnë se mbikëqyrja nuk kryhet sipas rregullave të përcaktuara. Dy elementet kyçe të cilat mungojnë te deputetët janë: ekspertiza dhe vullneti politik.

Për mbikëqyrje direkte mbi punën e shërbimeve të sigurisë-zbulimit janë të ngarkuar dy komisione parlamentare:

- Komisioni për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjencionit për zbulim,
- Komisioni për mbikëqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve nga ana Ministrisë së punëve të brendshme dhe Ministria e mbrojtjes.

Komisioni për mbikëqyrje të punës së Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe të Agjencionit për zbulim ishte themeluar në vitin 1995, si pjesë e reformave me të cilat u themeluan AZ dhe DSK. Ai ka detyrë specifike që të monitorojë se këto dy shërbime, gjatë punës së tyre, a e respektojnë ligjin, si dhe të drejtat dhe liritë e qytetarëve, ndërmarrjeve dhe subjekteve tjera juridike. Komisioni është përgjegjës edhe për kryerjen e vlerësimit të materialeve, pajisjes teknike dhe kadrovike të dy shërbimeve të sigurisë-zbulimit.⁴⁹ Komisioni për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe zbulim dhe Agjencionit për zbulim e përbëjnë nëntë anëtarë dhe tetë zëvendësa (të anëtarëve), të cilët i zëvendësojnë anëtarët e rregullt në rast të mungesës. Komisioni nuk ka shërbim këshillues dhe buxhet të pavarur, dhe për udhëheqjen e administratës së saj është i obliguar vetëm një person. Mbledhjet e Komisionit janë të karakterit të mbyllur, për shkak të specifikës së diskutimeve, gjatë kohës kur shkëmbehen informacionet e klasifikuara.

Nga ana tjetër, Komisioni për mbikëqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve nga ana e Ministrisë së punëve të brendshme dhe Ministrisë së mbrojtjes ekziston që më herët. Të njejtën e përbëjnë pesë anëtarë dhe katër zëvendësa të anëtarëve,

⁴⁹ Më shumë informacione për Komisionin për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjencionit për zbulim mund të lexohen në <http://sobranie.mk/en/default-en.asp?ItemID=07129CC529687F479390CEB4A34DDEE1>.

kurse u krijua nga ana e Kuvendit, me ligjin për ndjekjen e komunikimeve, në vitin 2006, me qëllim që të kryhet kontrolli i jashtëm i përdorimit të mbikëqyrjes elektronike nga ana e MPB dhe MM.⁵⁰ Deri më vitin 2008, detyrat e këtij Komisioni i takonin Komisionit për mbikëqyrje të punës së Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjensionit për zbulim. Në vitin 2010, Kuvendi vendosi ndryshime të reja, në mesin e të cilëve edhe ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për komunikime elektronike, me qëllim që t'i imponohet ofruesve të internetit dhe operatorëve të telefonave celular të instalojnë teknologji për ndjekje të komunikimeve elektronike nga ana e shërbimeve të sigurisë-zbulimit.⁵¹

Që të dy komisionet kanë në dispozicion qasje të pakufizuar deri te informacionet e klasifikuara dhe janë të autorizuar të realizojnë vizita në teren të shërbimeve të sigurisë-zbulimit mbi të cilët kryejnë mbikëqyrje. Kërkesa që kryetarët e komisioneve të jenë përfaqësues të partisë e cila është në opozitë, dukshëm ndikon në pavarësinë e tyre.⁵²

Mbikëqyrja nga deputetët

Deputetët nuk kanë trajnime speciale për mbikëqyrje mbi shërbimet e sigurisë-zbulimit, çka rezulton me mungesë të ekspertizës. Sipas funksionarit të dikurshëm të SShSUdheZ, “nuk ekziston metodologji sipas të cilës deputetët kryejnë mbikëqyrje dhe prej andej *de jure* kemi komisione, në vend të *de facto*“.⁵³ Ai nuk mundi të veçojë shembull kur komisioni parlamentar ka kryer vizitë në teren ose kur ka marrë çfarëdo aktivitet tjetër për kryerje të kontrollit. Kur bëhet fjalë për aftësinë e deputetëve për plotësimin e obligimeve të tyre për kryerje të mbikëqyrjes, funksionari i SShSUdheZ vërejti se, edhe kur deputetët do të kryenin mbikëqyrje, atyre iu mungon njohuri që të mund ta kuptojnë ato që e mbikëqyrin ose të veprojnë.⁵⁴ Esad Rahiq, i cili ishte kryetar i Komisionit për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjensionit për zbulim, në periudhën në mes të vitit 2006 dhe 2008, pohoi se vizita e tij në AZ “nuk kishte kurrfarë lidhje me kryerjen e kontrollit dhe mbikëqyrjes, por ishte vetëm një formalitet i pastërt”.⁵⁵

Edhe të dy funksionarët e ndajnë mendimin se ekziston mangësi sistemore në modelin e tanishëm të mbikëqyrjes parlamentare, veçanarisht kur bëhet fjalë për vizitat në teren.

Me ligjet e tanishme nuk është përcaktuar se vizitat në teren a duhet të paralajmërohen ose për të njëjtat paraprakisht a duhet të merret leje nga ana e shërbimeve të sigurisë-zbulimit. Procesi i mundishëm për organizimin e vizitave në teren, për momentin, në mënyrë të konsiderueshme e zvogëlon levërdinë e tyre. Sipas funksionarit të dikurshëm të SShSUdheZ,

⁵⁰ Ligji për ndjekjen e komunikimeve. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 121/2006).

⁵¹ Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për komunikime elektronike („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 83/2010).

⁵² Përveç kryetarit të komisionit i cili është pjesë e opozitës, edhe shumica e anëtarëve të Komisionit për mbikëqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve nga ana e Ministrisë së punëve të brendshme dhe Ministria e mbrojtjes janë pjesë të opozitës.

⁵³ Intervistë me përfaqësuesin e dikurshëm të lartë të SShSUdheZ, në 10 mars të vitit 2011.

⁵⁴ Ibid.

⁵⁵ Intervistë me Esad Rahiq, kryetar i dikurshëm i Komisionit për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe zbulim dhe Agjensionit për zbulim.

“periudha, gjegjësisht koha e cila është e nevojshme që të organizohet vizita, është aq e gjatë sa që drejtorët e sektorëve lehtë mund të manipulojnë me deputetët”.⁵⁶

Raportet në mes të kuadrit të shërbimeve të sigurisë-zbulimit dhe deputetëve janë të përziera. Nga njëra anë, sipas përfaqësuesit të dikurshëm të SShSU dhe Z, ata të cilët janë të përfshirë “nuk kanë zgjidhje dhe obligohen të bashkëpunojnë, sepse kjo është e përcaktuar me ligj”.⁵⁷ Nga ana tjetër, shërbimet ngadonjëherë i anashkalojnë ligjet. Për shembull, pas vizitës së Rahiqit në AZ, ai disa herë pa sukses u përpoq të organizojë vizitë të ngjajshme në Drejtorinë për siguri dhe kundërzbulim.⁵⁸

Para do kohësh, Kuvendi përcaktoi masa për t’u marrë me mungesën e ekspertizës në mesin e deputetëve. U themelua qendra e re hulumtuese, që t’i mundësohen deputetëve njohuri ekspertësh dhe informacione të reja. Qendra hulumtuese duhej të fillonte me punën e vet në fillim të vitit 2010. Deri në këtë moment, ajo ende nuk ka filluar me punë.

Raportimi

Kërkesat për dorëzimin e raporteve deri te komisionet parlamentare, nga ana e shërbimeve të sigurisë-zbulimit, janë të ndryshme për të dy shërbimet. DSK është e obliguar të dorëzojë raport deri te Komisioni për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjensionit për zbulim, një herë në vit, dhe ta informojë komisionin për zbatimin e planit aksional, dy herë në vit.⁵⁹ Nga AZ kërkohet që të dorëzojë vetëm raport vjetor, deri te Komisioni për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjensionit për zbulim.

Shqyrtimi (i këtyre kërkesave) është më shumë formalitet se sa praktikë. Për shembull, edhe DSK dhe edhe AZ, pritën që deri më 29 dhjetor të vitit 2010, vetëm dy ditë para fundit të vitit, t’i dorëzojnë raportet për vitin 2009. Gjithashtu, drejtori i DSK asnjëherë nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjensionit për zbulim, por çdo herë e dërgon zëvendësin e vet.

Procesi i kontrollit

Para se të fillojnë me punë, anëtarët e Komisionit për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjensionit për zbulim dhe të Komisionit për mbikëqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve nga ana e Ministrisë së punëve të brendshme dhe Ministria e mbrojtjes, obligohen të kalojnë nëpër procesin e kontrollit të sigurisë, me qëllim që pajisen me leje për punë me të dhënat e klasifikuara. Ky

⁵⁶ Intervistë me funksionarin e dikurshëm lartë të ranguar të SShSU dhe Z, në 10 mars të vitit 2011.

⁵⁷ Ibid.

⁵⁸ Intervistë me Esad Rahiq, kryetar i dikurshëm i Komisionit për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe zbulim dhe Agjensionit për zbulim.

⁵⁹ Ligji për punë të brendshme. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 92/09). Neni 41.

proces është problematik, sepse puna e anëtarëve të komisioneve varet nga miratimi që e japin organet jashta Kuvendit. Për shembull, Drejtoria për siguri të informacioneve të klasifikuara pranë Qeverisë e ka fjalën e fundit për dhënien e çertifikatës së sigurisë, kurse DSK ka rol kyç në procedurë, duke përcaktuar se dhënia e çertifikatës së sigurisë për qasje në të dhënat e klasifikuara paraqet “rrezik për sigurinë”. Edhe sikur DSK të mos e refuzonte deputetin, mund ta shtyn procesin deri në shkallë të njejtë me refuzimin.

Si rezultat i kësaj, anëtarët e komisioneve shpesh ballafaqohen me vështirësi që të marrin çertifikatën e sigurisë për qasje në të dhënat e klasifikuara. Gjatë kohës së punës së përbërjes së fundit të Kuvendit (viti 2008-2011) ishin të nevojshme shtatë muaj që kryetari i Komisionit për mbikëqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve nga ana e Ministrisë së punëve të brendshme dhe Ministria e mbrojtjes të fitojë çertifikatën, kurse disa anëtarë të komisionit as që morrën leje të tillë.⁶⁰ Megjithatë, sipas deklaratave zyrtare të Kuvendit, nuk vërehet shfaqje e tillë e problemit – deputetëve, çdo herë, me kohë i ndahen leje për punë me të dhëna të klasifikuara.⁶¹ Sipas njohurive joformale, afati i zakonshëm për dhënien e çertifikatës së sigurisë për punë me të dhënat e klasifikuara arrin prej tre deri dymbëdhjetë muaj.

4.3 Komisioni për financa dhe buxhet i Kuvendit

Buxhetet të cilat janë caktuara për shërbimet e sigurisë-zbulimit i miraton Kuvendi, si pjesë e procesit të zakonshëm për përgatitjen e buxhetit, përmes Komisionit për finansim dhe buxhet i Kuvendit.⁶² Në këtë proces, Komisioni për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe i Agjencionit për zbulim dhe Komisioni për mbikëqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve nga ana e Ministrisë së punëve të brendshme dhe Ministria e mbrojtjes, nuk luajnë kurfarë roli.⁶³ Për çdo rast, deputetët, si anëtarë të këtyre komisioneve, janë të autorizuar të marrin pjesë në mbledhje me karakter pune të Komisionit për finansim dhe buxhet të Kuvendit.

Ato, gjithashtu, edhe gjatë kohës të diskutimeve të tyre mund t’i shtrojnë pyetje shërbimeve të sigurisë-zbulimit të lidhura me shkallën buxhetore, që rradhë ndodh në praktikë. Së pari, numri më i madh i deputetëve nuk e posedojnë çertifikatën e domosdoshme për punë me të dhënat e klasifikuara që të mund të shtrojnë pyetje dhe të fitojnë përgjigje adekuate. Pastaj, sipas praktikës së gjerëtanishme, vendimet që i sjell komisioni duhet të miratohen me konsensus dhe kështu anëtarët e koalicionit në pushtet mund të votojnë *kundër* ose thjeshtë të mos marrin pjesë në mbledhjen dhe me këtë të mos plotësohet kuorumi i nevojshëm.

⁶⁰ N. Selmani, „Shërbimet sekrete e sundojnë parlamentin“. *Vest*. (i arritshëm në <http://www.vest.com.mk/?ItemID=8C12D57DEDEB54BA13FB80AFC225CEA>)

⁶¹ Informacione nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë të marra përmes shfrytëzimit të së drejtës për qasje deri te informacionet e karakterit publik.

⁶² Për shkak se buxhetet e shërbimeve të sigurisë - zbulimit përmbajnë informacione të klasifikuara të anëtarëve të Komisionit për finansim dhe buxhet, e nevojshme i është leje për punë me të dhënat e klasifikuara.

⁶³ Fondacioni „Fridrih Ebert shtiftung“ dhe Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave. *Udhërrëfjenjës në buxhete*. 64.

Dukuri e shpeshtë është që anëtarët e Komisionit për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjensionit për zbulim dhe të Komisionit për mbikëqyrje mbi zbatimin të masave për ndjekje të komunikimeve nga ana e Ministrisë së punëve të brendshme dhe Ministria e mbrojtjes të jenë anëtarë të Komisionit për financa dhe buxhet të Kuvendit, çka i jep mundësi të ndryshme që të fillojnë diskutim për buxhetin e shërbimeve të sigurisë-zbulimit. Sipas Esad Rahiqit, ekziston traditë e fuqishme burokratike e bashkëpunimit në mes të komisioneve për mbikëqyrje dhe Komisionit për financa dhe buxhet në Kuvend.⁶⁴

4.4 Mbledhjet plenare të Kuvendit

Pa marrë parasysh se a jeni anëtarë të Komisionit për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjensionit për zbulim dhe Komisionit për mbikëqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve nga ana e Ministrisë së punëve të brendshme dhe Ministria e mbrojtjes, ekzistojnë edhe dy mundësi tjera për deputetët për hulumtim të punës së shërbimeve të sigurisë-zbulimit. Që të dyja thuhet gjatë kohës së sesioneve plenare në Kuvend. E para është shtrimi i pyetjeve në Kuvend. Një herë në muaj, deputetët kanë mundësi t'i shtrojnë pyetje deputetësh ministrave në Qeveri, në lidhje me punën dhe kontributin e tyre. Pjesa e mirë e pyetjeve të shtruar deri te ministri për punë të brendshme i përkasin DSK, veçanarisht për drejtorin e DSK (për arsyen se ai është anëtar i Komitetit ekzekutiv i partisë në pushtet). Pyetjet zakonisht i shtron opozita, kurse përfaqësuesit e koalicionit qeveritar, në frymën e disiplinës partiake, e përkrahin punën e ministriva dhe përfaqësuesve qeveritar.

Mundësia tjetër është interpelanca me të cilën përfaqësuesit e opozitës ngadonjëherë shërbehen që të kompenzojnë mungesën e mbikëqyrjes në nivel komisionesh. Gjatë kohës së dekadës së kaluar, ministri për punë të brendshme dhe ministri për mbrojtje disa herë u ballafaquan me interpelancë. Deri më tani, asnjëri nga ata nuk u largua nga funksioni mbi atë bazë.

Deputetët, gjithashtu, gëzojnë të drejtën kushtetuese t'i shtrojnë pyetje kryetarit të shtetit lidhur me drejtimin e shtetit, në kuadër të kompetencave të tij, si për shembull për kontrollin mbi AZ. Në krahësim me mbikëqyrjen mbi DSK, ky mekanizëm pothuajse edhe nuk zbatohet.

4.5 Gjyqësori

Edhe pse gjyqësori ka obligime të ndryshme ndaj AZ dhe DSK, roli primar i tij në kryerjen e mbikëqyrjes mbi zbulimin është të kryejë vlerësimin e kërkesave të MPB dhe MM, për zbatimin e masave speciale hetuese, në mesin e të cilëve edhe masat për ndjekjen e komunikimeve. Që të shërbehen me këto masa (të numëruara në Ligjin për procedurë penale

⁶⁴ Intervistë me Esad Rahiq, kryetar i dikurshëm i Komisionit për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe zbulim dhe Agjensionit për zbulim.

dhe Ligjin për ndjekjen e komunikimeve)⁶⁵, MPB dhe MM paraprakisht duhet të fitojnë leje nga gjyqtari hetues, prokurori publik ose gjyqtari suprem.⁶⁶

Pas zbatimit të masave speciale hetuese⁶⁷, MPB është e obliguar të paraqesë raport deri te prokurori publik/gjyqtari hetues, ku do të theksohen:

- data kur filluan dhe u ndërprejnë të zbatohen masat speciale;
- identitetet e personave të cilët paraqesin grupin e qëllimit;
- përshkrimi i metodave të zbatuara dhe rezultateve përfundimtare.

Grupi i ekspertëve, për disa herë, theksuan se gjyqtarët hetues ndoshta edhe nuk janë në pozicionin më të mirë të vendosin për vendimet e MPB për zbatimin e masave speciale hetuese, për arsye se shumicës i mungon të kuptuarit më të thellë i problematikës.⁶⁸

4.6 Këshilli për siguri nacionale

Në anëtarët e Këshillit për siguri nacionale (KSN) numërohen kryetari i Republikës, i cili kryeson me të njëjtin, ministri për mbrojtje, ministri për punë të jashtme, ministri për punë të brendshme, kryetari i Kuvendit, kryetari i Qeverisë dhe tre anëtarë tjerë të emëruar nga ana e kryetarit të republikës.

Marrë në përgjithësi, KSN ka rol të pastërt këshillënës dhe takohet vetëm në rast të kanosjes së kërcënimit të fortë të sigurisë së shtetit, që ndodh mjaft rallë. Ky organ nuk ka autorizim direkt për shërbimet e sigurisë-zbulimit, por mund të vendosë ndryshime në politikën e sigurisë, të cilat indirekt do të ndikojnë mbi punën e shërbimeve.

4.7 Enti shtetëror për revizion

Duke marrë parasysh mjetet e mëdha financiare të cilat shpenzohen për sigurinë e shtetit (për shembull, buxheti i DSK ishte rritur deri në njëzet e pesë milion euro, në vitin 2009), mbikëqyrja e shërbimeve të sigurisë-zbulimit duhet gjithsesi të përfshijë mbikëqyrje rrënjësore të financave të shërbimeve. Bazament ligjor për këtë ofron Ligji për revizion shtetëror, ku janë të theksuar institucionet shtetërore, në mesin e të cilëve edhe AZ, MPB dhe

⁶⁵ Ligji për procedurë penale – teksti i pastruar. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 15/2005).

Ligji për ndjekjen e komunikimeve. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 121/2006).

⁶⁶ Sipas nenit 148 1 t e Ligjit për procedurë penale – teksti i pastruar („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 15/2005), prokurori publik dhe gjyqtari hetues mund të lejojnë zbatimin e masave speciale hetuese në procedimin parahetues, kurse gjatë kohës së hetimit për zbatimin e masave të tilla vendos vetëm gjyqtari hetues.

⁶⁷ Ligji për procedurë penale – teksti i pastruar. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 15/2005).

⁶⁸ Pandorçe Dimitrovska. „Ekspertët kundër keqpërdorimit të masave të veçanta hetuese“. 25 nëntor i vitit 2008. (i arritshëm në <http://vesti.alfa.mk/default.aspx?eventid=2583&mid=44>)

MM, të cilat i nënshtrohen inspekcioni financiar.⁶⁹

- analizën e dokumentacionit, ku është theksuar se raportet financiare të institucionit a e tregojnë saktë gjendjen e tyre financiare;
- hetimin dhe evaluimin e raporteve interne kontrolluese të institucionit;
- mbikëqyrjen mbi harxhimin e fondeve publike në lidhje me harxhimin në kuadër të kornizës së paraparë ligjore;
- evaluimin e masave të zbatuara sipas rekomandimit të Entit shtetëror për revizion.

Me Ligjin për revizion shtetëror, Entit shtetëror për revizion (EShR) iu është caktuar qasje deri te informacionet e n evojshme për kryerjen e revizionit, si dhe qasje deri te hapësirat e institucionit ku kryhet revizioni dhe dokumentacioni i tërësishëm i tij, pa marrë parasysh se dokumentacioni a përbëhet prej të dhënave të klasifikuara apo jo. Revizorët janë të autorizuar që të kërkojnë edhe sqarim të detajuar nga të punësuarit e institucionit ku kryhet revizioni. Ligjërisht është e ndaluar që institucioni ku kryhet revizioni ta pengojë punën e revizorëve, në cilën do qoftë mënyrë.⁷¹

Për konstatimet, EShR paraqet raport vjetor deri te Kuvendi dhe Komisioni për finansim dhe buxhet i Kuvendit. Në këto raporte bien edhe raportet nga vetë revizionet. Gjithashtu, EShR çdo vit ia bashkangjet Kuvendit listën e institucioneve ku do të kryhet revizioni vitin që pason.

EShR nuk kryen revizione të posaçme në DSK dhe SShSUDheZ, por në ministritë të cilave ato i përkasin (MPB ose MM). Nga viti 2001 e këndej, EShR ka të kryer një revizion në AZ, tri herë në MPB dhe dy herë në MM. Revizioni në AZ nuk tregoi keqpërdorim të fondeve, as mosrespektim të Ligjit për furnizime publike ose të çfarëdo parregullësie gjatë harxhimit. Përkudër kësaj, gjatë kryerjes së revizionit në MPB dhe MM u hasën mangësi serioze, në mesin e të cilëve edhe mosrespektimi i rregullave për furnizime publike dhe lëshime në kontrollin mbi pagesën e brendshme.

Kur EShR do të hasë në shpenzim jo adekuat ose në ndonjë mosrespektim të ligjit, detyrimisht jep rekomandime për tejkalimin e lëshimeve. Institucioni ku kryhet revizioni ka njëzet ditë afat ta informojë EShR për masat e marra, në përputhshmëri me rekomandimet e EShR. Për një vit, EShR sërish kryen revizion me qëllim që të konfirmojë se rekomandimet a janë zbatuar dhe respektuar në mënyrë adekuate. Në ndërkohë, EShR gjithsesi duhet ta

⁶⁹ Ligji për revizion shtetëror. („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 66/2010). Neni 2.

⁷⁰ Ibid. Neni 19.

⁷¹ Ibid. Neni 25.

informojë prokurorin publik, në mesin e organeve të tjerë kompetent, nëse disa parregullësi paraqesin vepra penale.⁷²

5. Mediumet dhe shoqëria civile

Pjesa e konsiderueshme e vëmendjes mediale në Maqedoni është e drejtuar drejt punës së shërbimeve të sigurisë-zbulimit, edhe atë deri në atë shkallë që, në raste të caktuara, kontributet mediale kanë luajtur rol me rëndësi në zhvillimin demokratik në sektorin e sigurisë. I tillë ishte edhe rasti me aferën “Veshi i madh”, në vitin 2001. Gazetarët ishin pjesë të grupit të qëllimit i cili ishte lëndë për ndjekje nga ana e shërbimeve. Si rezultat i asaj, ata kryen shtypje që ministri i atëhershëm për punë të brendshme dhe njëri prej zëvendësave kryesor të ballafaqohen me kundërvatje penale. Gjykimi i filluar ishte ndërprerë për shkak se kryetari Boris Trajkovski amnistoi përfaqësuesit e tillë qeveritar. Gazetarët sërish u bashkuan dhe paraqitën ankesë kundër shtetit. Shtatë vite më vonë, përfundimisht u soll aktgjykimi me të cilën u vërtetua se MPB, me ndihmën e Telekomunikacioneve maqedonase, joligjerisht e kanë përgjuar komunikimin në mes të shtatëmbëdhjetë gazetarëve, të cilët pas aktgjykimit fituan kompensim nga shteti.

Viteve të fundit, raporti në mes të mediumeve dhe shërbimeve të sigurisë-zbulimit u përkeqësua. Sipas Katerina Geteva, e cila është pjesë e gazetarëve të cilët e mbulojnë punën e këtyre shërbimeve, “AZ është më së paku e hapur për bashkëpunim me gazetarët nga të tri shërbimet e sigurisë-zbulimit”.⁷³ Geteva morri ndalesë për komunikim me të punësuarit në AZ, për shkak të mënyrës së vet proaktive dhe hulumtuese të prononcimit.⁷⁴ Në kundërshtim me AZ, DSK është më transparente në strategjinë e saj për bashkëpunim me mediumet dhe vetë vendos komunikim me gazetarët, përmes zëdhënësit të MPB. Nga ana tjetër, drejtori i tanishëm i DSK, edhe përkundër interesit të madh në opinion për punën e DSK, nuk ka të dhënë deklaratë për gazetarët, që nga viti 2006, kur erdhi në funksion.

Marrëdhëniet në mes të mediumeve dhe komisioneve parlamentare për mbikëqyrje janë shumë të mirë. Kjo kryesisht bazohet në atë se kryetarët e Komisionit për mbikëqyrje mbi punën e D rejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe Agjensionit për zbulim dhe Komisionit për mbikëqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekje të komunikimit nga ana e Ministrisë së punëve të brendshme dhe Ministrisë së mbrojtjes, patjetër janë përfaqësues të opozitës. Për këtë, ata çdo herë janë të gatshëm t’i shtrojnë mangësitë para opinionit. Ky nuk është rast edhe me trupat tjerë për kryerje të mbikëqyrjes mbi shërbimet e sigurisë-zbulimit. Për shembull, siç spjegon Geteva, “Avokati i popullit asnjëherë nuk e ka treguar dhe nuk e ka promovuar autorizimin e vet për mbikëqyrje mbi punën e shërbimeve”.⁷⁵

Përveç mediumeve, ekzistojnë edhe aktorë të tjerë të shumtë nga shoqëria civile të cilët nuk tregojnë interesim të veçantë për përfshirje në mbikëqyrje mbi shërbimet e sigurisë-

⁷² ESHR dorëzoi rast deri te Zyra e Prokurorit publik për shkak të parregullësive të vërejtura në raportin përfundimtar të revizionit i ESHR për Ministrinë e mbrojtjes.

⁷³ Intervistë me Katerina Geteva, gazetare e cila kumton për sektorin e sigurisë, në 22 gusht të vitit 2001.

⁷⁴ Ibid.

⁷⁵ Ibid.

zbulimit. Organizatat, si “Analitika” dhe Komiteti i Helsinkut për të drejtat njerëzore, janë të kyçur në kryerjen e vlerësimit të reformave në sektorin e sigurisë (pjesë e së cilës janë edhe këto shërbime) dhe frytshëm i shprehin qëndrimet e veta për legjislacionin e propozuar. Raportet lartë të profilizuara mediale dhe iniciativat qytetare rezultuan me shfaqimin e disa dispozitave nga Ligji për Agjencionin për zbulim si jokushtetuese,⁷⁶ por ato paraqesin përjashtime, por jo rregulla.

Përfundimi

Organet për mbikëqyrjen e shërbimeve të sigurisë-zbulimit në Maqedoni tregojnë shenja brengosëse. Edhe përkaj asaj që korniza ligjore për punën e tyre është në mënyrë të duhur e vendosur, te një pjesë e ligjeve, siç është Ligji për Agjencionin për zbulim, paraqitet nevoja për revizion. Zgjidhje më e mirë do të ishte të miratohet korniza e vetme ligjore e cila do t’i përfshijë të gjitha trupat për mbikëqyrje, me çka do të arrihet bashkimi i detyrave të shpërndara dhe krijimi i strukturës së integruar dhe voliminoze për mbikëqyrje.

Përveç kësaj, anëtarëve të komisioneve parlamentare për mbikëqyrje i mungon vullneti politik për kryerjen e obligimeve, të cilat iu janë ndarë në përputhshmëri me autorizimet të cilat i kanë të fituara me ligjin e tanishëm. Mediumet dhe aktorët tjerë nga shoqëria civile shërbejnë për kryerjen alternative të kontrollit të shërbimeve të sigurisë-zbulimit, por duhet të bëhet më tepër në lidhje me mbindërtimin e diturisë dhe aftësive të tyre.

Për fund, çfarëdo që të propozohet me propozim-ligjin qeveritar për shërbimet e sigurisë-zbulimit, ai duhet të përmbajë më shumë vegla efikase për kryerje të mbikëqyrjes, me qëllim që të baraspeshohet koncentrimi i ri i fuqisë në Ministrinë për punë të brendshme.

⁷⁶ Aktgjykimi i Gjyqit kushtetues nr. 76/2000 dhe 211/2000.

Rekomandime

- Propozimi qeveritar për riorganizimin e shërbimeve të sigurisë-zbulimit duhet të jetë i hapur për diskutim publik. Duhet të kyçen të gjithë faktorët relevant, në mesin e të cilëve edhe ekspertët e jashtëm dhe organizatat e shoqërisë civile.
- Duhet të miratohet ligj për mbikëqyrje mbi shërbimet e sigurisë-zbulimit, ku detajisht do të përpunohet qasja e koordinuar për kryerje të mbikëqyrjes mbi Agjensionin për zbulim, Drejtorinë për siguri dhe kundërzbulim dhe Sektorin-Shërbimin për siguri dhe zbulim ushtarak.
- Gjatë emërimit të anëtarëve të komisioneve parlamentare për mbikëqyrje të partive politike duhet të garantohen se të anëtarët e emëruar ekziston interesim për punë në sferën përkatëse, si dhe të përpiqen me këmbëngulje të njëjtët të ken përvojë/arsimim në sferën e së drejtës.
- Anëtarët e komisioneve parlamentare për mbikëqyrje duhet të vizitojnë trajnime të specializuara nga fusha, siç janë mbikëqyrja e buxhetit dhe funksionimi i shërbimeve të sigurisë-zbulimit.
- Kuvendi duhet të punësojë kuadër plotësues, ku do të përfshihen edhe këshilltarë të cilët do t'i ofrojnë përkrahje komisioneve për mbikëqyrje në punën e tyre.
- Qendra për hulumtim e Kuvendit duhet ta fillojë punën e saj, pa pezullime të mëtutjeshme.
- Të punësuarit në Agjensionin për zbulim dhe në Drejtorinë për siguri dhe kundërzbulim duhet të ndjekin trajnime dhe seminare, në mënyrë që më mirë të njihen me konceptin e kryerjes së mbikëqyrjes dhe me rëndësinë e saj për shoqërinë demokratike.
- Gjyqtarët hetues duhet të vizitojnë trajnime të specializuara në lidhje me ndarjen e autorizimeve për zbatimin e masave speciale hetuese.

Bibliografia

Burimet primare

1. Ligji për mbrojtje („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 42/2001), 1 qershor i vitit 2001.
2. Ligji për buxhet („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 64), 3 gusht i vitit 2005.
 - Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhet („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 103), 19 gusht i vitit 2008.
 - Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhet („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 156), 25 dhjetor i vitit 2009.
3. Ligji për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.
4. Rregullorja e punës e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, 18 qershor i vitit 2008.
5. Ligji për Avokatin e popullit („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 60/2003), 22 shtator i vitit 2003.
6. Ligji për revizion shtetëror („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 73/04), 21 tetor i vitit 2004.
7. Raporti vjetor për punën e Avokatit të popullit për vitin 2008 (i afrueshëm në: [//www.ombudsman.mk/comp_includes/webdata/documents/Godisen%20izvestaj-2008.pdf](http://www.ombudsman.mk/comp_includes/webdata/documents/Godisen%20izvestaj-2008.pdf). Për herë të fundit e hapur në 21 mars 2010).
8. Rregullorja për punë e Avokatit të popullit.
(i afrueshëm në:
http://www.ombudsman.mk/comp_includes/webdata/documents/Delovnik.PDF. Për herë të fundit e hapur më 18 mars të vitit 2010).
9. Ligji për Agjensionin për zbulim („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 19/1995).
10. Ligji për polici („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 114/2006).
11. Ligji për punë të brendshme („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 92/2009).
12. Shenimet stenografike të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, prill i vitit 1993. Faqja 22.
13. Zyra e Komisarariatit të lartë për të drejtat e njeriut e Kombeve të bashkuara. Protokoli fakultativ drejt Konventës kundër mundimit dhe sjelljes ose dënimit tjetër të vrazhdë, jonjerëzor dhe poshtërues.
14. Ligji për ndjekjen e komunikimeve („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 121/2006).
15. Ligji për procedurë penale – teksti i pastruar („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 15/2005).

Burimet sekondare

1. Grupi ndërkombëtar i krizave. *Raporti nr. 109, Çështja maqedonase: Reformë ose kryengritje*, 5 prill i vitit 2001.
2. Fondacioni „Fridrih Ebert shtiftung“ dhe Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave. *Udhërrëfjës në buxhete*. Faqja 64.
3. *Raporti deri te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për vizitën në Republikën e Maqedonisë, të kryer nga Komiteti evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimin ose dënimit çnjerëzor dhe degradues (KPT), 15 - 26 maj i vitit 2006 (viti 2008): 22.*
4. Masat speciale hetuese (viti 2010): 19, 22. Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë, Misioni vëzhgues për shpërndarje të konflikteve në Shkup.

Intervisat

1. Intervistë me Esad Rahiq, kryetar i dikurshëm i Komisionit për mbikëqyrje mbi punën e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe i Agjensionit për zbulim (viti 2006–2008).
2. Intervistë me funksionarin e dikurshëm të lartë të Sektorit-Shërbimi për siguri ushtarake dhe për zbulim, në 10 mars të vitit 2011.
3. Intervistë me përfaqësuesin e shërbimeve të sigurisë-zbulimit, në 18 gusht të vitit 2011.
4. Intervistë me Katerina Geteva, gazetare e sektorit të sigurisë, në 22 gusht të vitit 2011.

Pyetësorë

Në pajtim me Ligjin mbi qasjen e lirë deri te informacionet e karakterit publik, për nevojat e këtij studimi, u dërguan më shumë se shtatëdhjetë e pesë pyetje deri te institucionet: Ministria e punëve të brendshme, Ministria e mbrojtjes, Agjensioni për zbulim, Avokati i popullit, Enti shtetëror për revizion dhe Kuvendi.